



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0707**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vjosa Gradinaj Mexhuani duke vendosur sipas ankesës së Operatorit ekonomik (OE) LINDI MARKINGS SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zgjerimi i sinjalizimit turistik Faza - II” me numër të prokurimit 635-23-8759-5-2-1, inicuar nga Autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES, më 02/11/2023, mori këtë:

### **Vendim**

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE LINDI MARKINGS SH.P.K. me Nr.protokolli 2023/0707, e datës 18.09.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zgjerimi i sinjalizimit turistik Faza - II”, me numër të prokurimit 635-23-8759-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Pejës, ndërsa vendimi i AK i datës 08.09.2023 lidhur me aktivitetin e lartcekur mbetet në fuqi.

2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 17.08.2023, Komuna e Pejës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Zgjerimi i sinjalizimit turistik Faza - II”, me numër të prokurimit 635-23-8759-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Pejës. Ndërsa me datën 08.09.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë e OE PRO PRINT SHPK.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 25,000.00 €.

Me 12.09.2023, OE LINDI MARKINGS SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 13.09.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 18.09.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE LINDI MARKINGS SH.P.K, me nr. 707/23 lidhur me aktivitetin “Zgjerimi i sinjalizimit turistik Faza - II”, me numër të prokurimit 635-23-8759-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Pejës.

*-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues LINDI MARKINGS SH.P.K, janë parashtruar si në vijim:

***Pretendimi i parë (I)*** Ankuesi pretendon se “Kompania “Lindi Markings” shpk, në këtë procedurë të prokurimit ka ofertuar me ofertë të përgjegjshme dhe me çmimin me te lire dhe për kundër këtij fakti AK - Komuna Pejë, detyrimisht tenton ta eliminon ofertën tone në mënyrë që ta keq përdor apo edhe ta përvetësoj parandë publike. Tek pozicioni nr. 2, i kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional ju si AK keni kërkuar: Kërkesa 2 Dorëzimi i mostrës për materialin e kërkuar sipas parametres dhe specifikimit teknik, Dëshmia 2 Për një mostër për produktin e kërkuar të Aneksi 1 të Specifikimit Teknik, mostrat duhen të sillen në kopje fizike para hapjes së ofertave. Vërejtje Mostra duhen të sillen në zyrën e prokurimit në ditën e hapjes para orës 12:00 AK- Komuna Peje, në letrën standarde të potencuar se “mungon pllaka baze nga metali me madhësi 50cm X 15 cm e cila duhet të ankerohet në bazën e betonit. Ndërsa AK, në mostrën e dorëzuar nuk është pllaka baze nga metali me madhësi 50 cm x 15 cm e cila kërkohet tek SPECIFIKIMI TEKNIK në Dosjen e Tenderi/ Po ashtu, mungon dizajni i mostrës me tekstet e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues sipas pikës së përshkrimit. Kompania jone ka prezantuar mostrën tek Autoriteti Kontraktues - Komuna Peje, mostër kjo e cila i plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara tek kërkesat kualifikuese dhe AK me vendimin për eliminim të ofertës sonë ka konsumuar shkelje substanciale të dispozitave ligjore dhe nënligjore për prokurim publik. Qëllimi i caktuar, për të favorizuar kompaninë e rekomanduar për dhënie të kontratës dhe për të keqpërdorur parandë publike tregohet me vet faktin se me datën 06.09.2023 janë hapur ofertat dhe me datën 08.09.2023, keni publikuar njoftimin mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit. Përdoruesi OE i rekomanduar për dhënie të kontratës fare nuk ka prezantuar mostër. Futja në beton ankerimi dhe përshkrimi i logos është kërkesë e implementimit të kontratës jo kërkesë e kualifikimit të ofertës. Fakti dhe arsyetimi i eliminimit është absurd tendencioz dhe si i tillë do të sjellë AK-se, pasojat financiare dhe pasojat juridike Çështja e kërkesave kualifikuese kërkesave të dhënies së kontratës dhe kërkesave zbatuese apo implementuese të kontratës, nëse kompani nuk duam ta besojmë që nga AK Komuna Peje nuk dine ti dallojnë. Ky mos dallim ka qellim të caktuar. Kjo konfirmohet me faktin tjetër se ndaj kompanisë sonë përkundër ofertës financiare me te lire, i referoheni mostrës së prezantuar e cila do të vërtetohet nga organet kompetente dhe do të krahasohet me mostrën e operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës, meqë vlerësimi i ofertave është bërë në mënyrë të njëanshme dhe me qellim të caktuar. AK - Komuna Peje, me teje në letrën standarde ka shtuar arsye tjera për mostër tjetër të “tabelë të llamarinës”, ndërsa tek kërkesat e kualifikimit është kërkuar vetëm një mostër, me këtë veprim AK - Komuna Peje, përkatësisht zyra e prokurimit ka shkelur parimet e prokurimit, ka shkelur edhe nenin 52, paragrafi 3, ku përcaktohet: “Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat

paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim...Ndërsa neni 56, paragrafi 3 i LPP-se përcakton: "Tenderuesi, gjate procedurave të hapura, ose kandidati, gate procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. AK - Komuna Peje përmes specifikacioneve teknike të detyrueshme ka përcaktuar dizajnin specifikat dhe kualitetin e produktit në si kompani kemi prezantuar mostrën konform kërkesës së AK-se dhe konform UA nr. 09/2017, për sinjalizim dhe rregullat e trafikut rrugore, përkatësisht neni 10. Lidhur me dizajnin në specifikacion teknik të detyrueshme çarte përcaktohet që tabela duhet të jete në të dy anët me folie ndërsa tekstet tjera do të propozohen nga menaxheri i projektit dhe kompania do të finalizoj ato. ti prezantoi mostrat në OSHP, në mënyrë që të vërtetohen saktë pretendimet tona dhe të raportohet abuzimi me parane publike dhe tentimi për keqpërdorim të financave publike."

**Pretendimi i dytë (II):** Ankuesi pretendon se "Fakti tjetër që tregon shpërfaqjen e AK, Zyra e Prokurimit - Komuna Peje, abuzimin me parane publike dhe eliminimin e konkurrencës së lire, kur është rekomanduar për dhënie të kontrate, operatorin ekonomik i cili ka dorëzuar dëshmi në emër të tri subjekteve të ndryshme: Qarkullimin bankar është dorëzuar në emër të PRO PRINT I)PSH me nr biznesi 70662221, për vitet nga 2019 deri 2022. Është dorëzuar certifikata e Biznesit është dorëzuar në emër të DPSH "PRO — PRINT" Biznes individual, me nr 810756679, Ndërsa deklarata nën betim, certifikata e regjistrimit të biznesit është dorëzuar në emër të PRO PRINT SHPK, me numër të biznesit: 812027549. Në emër të njëjtit biznes është dorëzuar edhe sigurimi i tejetit. ndërsa kapacitetet tjera mbulohen nga subjekte tjera. PRO PRINT SHPK, sipas certifikatës së regjistrimit është regjistruar me datën 23.03.2023. Ju si AK, pranoni dheshmit tjera të kapaciteteve tjera në emër të subjekteve tjera, të cilat kanë numër tjetër. PROVE: vërtetimet e ndryshme të subjekteve të ndryshme qarkullimi bankar dhe të tjera prova. Pra AK — Komuna Peje, përkatësisht zyra e prokurimit, ka rekomanduar për dhënie të kontratës Operator Ekonomik, i cili ka ofertuar me tre (3) subjekte të ndryshme. ndërsa për eliminim të ofertës sonë përdorni arsye të eliminimit për kërkesa të cilat nuk kanë qenë pjesë e dosjes së tenderit dhe as pjesë e kërkesave kualifikuese. Të gjitha këto veprime kundërligjore AK- Komuna Peje, dhe zyrtaret përgjegjës të prokurimit duhet ta ngarkojnë me përgjegjësi ligjore përfshirë edhe anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, pasi që sipas nenit 59 të LPP-se, përgjegjësia e anëtarëve të vlerësimit të ofertave është individuale, ndërsa neni 97, i rregullores së prokurimit publik nr. 001/2022, të gjitha këto veprime i konsideron si shkelje të rënda nga zyrtari përgjegjës i prokurimit: Falsifikimi, fshehja apo eliminimi i dokumenteve gjatë zhvillimit të një procedure të prokurimit; Mos respektimi apo shkelja e parimeve themelore të prokurimit publik të përcaktuar me LPP. Shkeljet e parimeve themelore përfshijnë, vendosjen e kritereve apo dëshmime në përputhje me LPP apo përshtatjen për një ofertues të caktuar, trajtim jo të barabartë të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, përveç specifikimit teknik që bie në përgjegjësinë e Njesisë së kërkesës. Nëse kërkesat e përshtatshmërisë dhe/ose kushtet e kualifikimit të përcaktuara me nenin 23 të Ligjit të Prokurimit Publik nuk janë plotësuar, ose me nuk i plotëson. Për cilindo veprim të specifikuar në nenin 130 të Ligjit të Prokurimit Publik që faktikisht ka kryer apo është përfshirë zyrtari i prokurimit e që rezulton me ndjekjen penale të një veprimi të tillë. Nëse ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për sjellje të gabuar apo jo profesionale të një zyrtari të prokurimit ndaj operatori ekonomik apo ndaj cilit do person gjatë ushtrimit të procedurës së prokurimit."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE LINDI MARKINGS SH.P.K, konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 24, 28, 52, 56, 59, 60 të LPP dhe 97 të Rregullores për Prokurim Publik duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 19/09/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 707/23, ndërsa me datë 25/09/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0707 me rekomandimet si në vijim: *“eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.”*

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është deklaruar rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimin e parë të Ankuesit, eksperti shqyrtues ka kërkuar sqarime nga AK, që të dërgon foto për secilin OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit për mostrat e dorëzuara sipas kërkesës se kërkuar dhe pas pranimi të fotografive të mostrave ka sqaruar: *Duke ju referuar fotografive të dy ofertuesve vërehet se OE ankues mostrën e dorëzuar per artikullin 1 nuk është sipas kërkesave të kërkuara në Aneksin 1 specifikacionet teknike të detyrueshme pasi që është kërkuar të Konstruksioni i Tabelës – Në konstruksion futet edhe pllaka bazë nga metali e cila duhet të ankerohet në bazën e betonit. Po ashtu mostra e dorëzuar nuk përmban asnjë tekst ashtu siç është specifikuar te aneksi 1 i dosjes së tenderit. Sa i përket Artikullit 2 Sinjalizimi kulturor, OE ankues nuk ka dorëzuar fare mostër për këtë artikull ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë si dhe te aneksi 1 i dosjes së tenderit andaj është pretendim ankimor i pa bazuar.*

Lidhur me pretendimin e dytë të OE eksperti shqyrtues ka konstatuar se është i pa bazuar pasi që: *OE i rekomanduar për kontratë në bazë dokumentacionit të ofertës se tij ka dorëzuar certifikatën e biznesit me numër unik identifikues 812927549 i datës 23.03.2023 e ndërron tipin e statusit duke kaluar nga Biznesi individual me emër të biznesit ‘Shpend N. Belegu B.I.’ me emër tregtar D.P.SH “PRO –PRINT” kalon në status në “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” me emër të biznesit “PRO PRINT” sh.p.k., dhe është vazhdim i biznesit të mëhershëm ashtu siç është shënuar në faqen 2 të certifikatës së biznesit. Nga kjo shihet se me rastin e ndërrimit të statusit të*

*kompanisë me emër tregtar “PRP PRINT” sh.p.k asnjëherë nuk është ndryshuar që do të thotë që në informata mbi biznesin faqe 2 të certifikatës citoj” dhe është vazhdim i biznesit të mëhershëm.”*

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues LINDI MARKINGS SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit shqyrtues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “LINDI MARKINGS SH.P.K, SHPK, janë të pa bazuara.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Duke vepruar në harmoni me kompetencat e parashikuara me nenin 105, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritohet të merret edhe pa degjimin e palëve në seancë. Prandaj me rastin e administrimit të provave në dispozicion, shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, Paneli konsideron raportin e ekspertit shqyrtues përmban në parim konstatime reale dhe për rrjedhojë i njëjti pranohet në tërësi.

Prandaj bazuar shkurtimisht në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se ankuesi nuk i ka plotësuar kushtet e parashikuara me DT, sikurse kërkohet sipas nenit 27 të LPP lidhur me specifikimet teknike të parapara me nenin 28, të LPP dhe si rrjedhojë nuk ka shkelje të nenit 1, 6,7, 56.3, 59 dhe 60 të LPP. Paneli Shqyrtues thekson se në çdo rast, jo vetëm që nga OE kërkohet plotësimi i DT në harmoni me kriteret e parapara, me dispozitat e LPP dhe në varësi të natyrës dhe qëllimit të aktivitetit të prokurimit, por njëherësh është gjithnjë detyrim ligjor i AK (në çdo nivel, lokal apo qendror) respektimi i dispozitave të LPP.

Andaj Paneli shqyrtues bazuar në të dhënat e përshkruar si më sipër, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si të bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të Vërtetuar Vendimin e AK - B58 të datës 08.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Zgjerimi i sinjalizimit turistik Faza - II” me numër të prokurimit 635-23-8759-5-2-1 iniciuar nga Komuna e Pejës.

Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit të prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Si dhe OE ankues në këtë rast nuk ka ofruar provë/argument bindës për panelin shqyrtues që rrjedhimisht do të ndikonin në ndryshim të vendimit përfundimtar të AK-së, andaj duke u bazuar nga të gjitha si që u thanë si më sipër është vendosur sikurse në dispozitiv që ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vjosa Gradinaj**

**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES**
- **OE - LINDI MARKINGS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: